

horizonte

JUNIA

Të drejta të njëjta për të gjithë migrantët!

Moti i keq dhe siguria në punë

Në rast rreziku ndalo punën!

2

Kongresi i parë i migrantëve

Me manifest e plan veprimi!

3



Një sindikatë në lëvizje

Unia feston 10 vjetorin?!

4

Nr. 7 | dhjetor 2014 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Votimet federale, Politika e migracionit

Lufta vazhdon më tej



Pamje nga manifestimi i organizuar nga shumë organizata e parti kundër Ecopop-it

Pas kampanjës intensive forcat progresive të vendit mund të marrin frymë lirshëm. Ecopop u hodh poshtë qartas me 74,1% të votave. Edhe pse ky rezultat mund të konsiderohet si i suksesshëm, migrantët edhe më tej do të shërbejnë si dele e zezë. Andaj edhe përkundër kësaj nevojitet edhe më tej angazhimi ynë i përbashkët si në rastin e zbatimit të Iniciativës për migrimin masiv ku duhet kundërshtuar kontingjentet dhe lejet diskriminues të qëndrimit ashtu edhe për votimet tjera relevante të politikës së migracionit.

Në të dielën votuese të 30 nëntorit më në fund u mundësua festimi në rrafshin e politikës së migracionit: Iniciativa Ecopop u refuzua qartas me 74,1%. Iniciativa në fjalë nuk morri shumicën e votave në asnjërin nga Kantonet.

Unia është angazhuar fuqishëm kundër kësaj iniciative sikur përmes kampanjës vetjake ashtu edhe në kuadër të Komitetit «Zvicra solidare – kundër Ecopopit».

Jo edhe mbi tatimin paushall

Më 30 nëntor u votua gjithashtu edhe për iniciativën mbi tatimin paushall. Edhe pse iniciativa e cila kërkonte anulimin e tatimit paushall për pasanikët e huaj në Zvicër u refuzua, megjithatë ajo arriti të sukses të konsiderueshëm: rreth 40,8% të votuesve ishin për anulimin e tatimit paushall. Pos kësaj është votuar edhe për iniciativën e arit, e cila gjithashtu u hudo poshtë qartazi.

Votimet kantonale lidhur me politikën e migracionit

Në Kantonin e Basel- qytetit pos tjerash është votuar edhe për një iniciativë kantonale të SVP-së (Partisë Popullore të Zvicrës), e cila parashihet që për pjesëtarët e shteteve të treta detyrimisht të lidhen marrëveshje integruese. Me 72,9% të votave u hodh poshtë edhe kjo iniciativë, ndërsa përkundrazi u aprovua kundërpropozimi i cili parashihet që të gjithë ardhacakët në vitin e parë të kenë të drejtën e vijimit falas të kursit të gjermanishtes. Kjo shënon një hap përpara në politikën integruese.

Unia kundër kontingjentëve

Pas refuzimit të Ecopop-it Unia do të angazhohet tani edhe më fuqishëm me rastin e zbatimit të iniciativës mbi migrimin masiv kundër rregullave të reja diskriminuese si a



Pjesëmarrje laramane në demonstrim



Unia gjithmonë në ballë të protestave

përket lejeve dhe statuteve të qëndrimit për migrantet.

Unia angazhohet për një Zvicër të hapur dhe për qarkullimin e lirë si të drejta themelore të punëmarrësve. Mirëpo kjo funksionon vetëm nëse kushtet e vlefshme të punës në Zvicër dhe sigurimi i pagave si dhe përmirësimi i mbrojtjes së të punësuarve me rast të largimit nga puna. Për këtë duhet forcur masat mbrojtëse gjithëpërfshirëse dhe duhet të zgjerohet mbrojtja përmes Kontratave Kolektive të Punës.

Migracioni nuk është «problem»

Ne duhet dhënë fund ndërlidhjes së «problemeve», qofshin ato reale apo difuze, me migracionin, gjë që tanimë e bëjnë forcat (borgjeze) të djathta politike. Mbyllja betonuese e Zvicrës apo trenat e mbushur përplot nuk kanë çka të kërkojnë në po-

litikën e migracionit dhe integritimit. Ato duhet të zgjidhen me planifikim hapësor dhe politik mjedisore të mençur e kurrsesi jo me politikë fajësuese.

Të gjithë së bashku kundër ksenofobisë

Ne tanimë nuk duhet të ndalemi. Ne duhet të angazhohemi jo vetëm për përmirësimin e të drejtave të, porse veçanërisht të luftojmë kundër atmosferës ksenofobe në vend. Votime tjera ksenofobe na presin në vitet e ardhshme, fala bie iniciativa ekzekutive, mirëpo edhe zbatimi i iniciativës së migrimit masiv. Ne vetëm të bashkuar ia arrijmë të mbrohemi, pasi forcat e djathta popullore në vend janë të fuqishme. Migrantet e migrantët duhet të ngritin zërin dhe të luftojnë për më shumë të drejta për të gjithë!

© Aurora García

Editorial



Viti 2014 ishte i vështirë sa i përket politikave të migracionit. Askush – e edhe ne – nuk kemi pas llogaritur me aprovimin e iniciativës mbi migrimin masiv të SVP-së (Partisë Popullore të Zvicrës). Vetëm pak kohë para fundjavës votuese të datës 9 shkurt u bë gjithmonë e më e qartë se iniciativa në fjalë do të kaloi.

Qe 25 vite popullsitë të SVP-së bëjnë kampanje politike në kurriz të migrantëve. Përmes kësaj SVP-ja është fuqizuar dhe në ndërkohë ia ka arritur që me një shumicë të ngushtë dalluese të fitojë votimet ksenofobe. Edhe pse Ecopop-i shumë qartas është hedhur poshtë, mjerisht atmosfera ksenofobe nuk është eliminuar. Sindikata Unia që nga krijimi i saj angazhohet kundër ksenofobisë. Ndër të tjera edhe përmes kampanjës «pa ne nuk ka Zvicër». Mjerisht është treguar më e vështirë të krijohet atmosferë pozitive karshi migrantëve e migrantëve, se sa të krijohet frikë me tituj negativ kundër «tjerëve» dhe kështu të përhapet ksenofobia.

Mirëpo ne nuk do të dorëzohemi. Ne e dimë që Zvicër pa këta shumë njerëz që nuk kanë pasaportë zvicerane, të cilët tek ne në jetojnë e punojnë këtu, nuk mund të ekzistojë! Zvicra gjendet në mes të Evropës. Ne duam ta kalojmë mirë me fqinjë tanë dhe nuk duam të izolohemi edhe më tej. Kooperimi me të tjerët qon përpara hulumtimin, ekonominë dhe njerëzit. Mbyllja në gëzhhojë ka domethënie të kthimit mbrapa. Mirëpo ne duam të ecim përpara dhe besojmë në zhvillime pozitive në të ardhmen.

Mirëpo kjo nuk arrihet vetvetiu. Për një të ardhme pozitive ne duhet të luftojmë bashkërisht. Migrantet, migrantët dhe zviceranet e zviceranët. Organizatat të cilat u angazhuan bashkërisht kundër Ecopop-it, do të angazhohen edhe në të ardhmen bashkërisht për një Zvicër të hapur dhe solidare. Ne llogarisim edhe mbështetjen tënde.

Rita Schiavi

Anëtare e Bordit Drejtues në Unia

News

Sukses për punonjësit grevistë të Pavatex-it



Aksioni luftarak i punonjësve të Pavatex-it në Fribourg tregoj rezultat: Kresat e tyre që edhe Unia duhet të përfshihet në bisedimet për një plan social, u pranua edhe nga drejtoria tek pas tri ditësh grevë. Në fund të tetorit Pavatex pat paralajmëruar mbylljen e selisë në Freiburg. Nga kjo janë prekur 45 punonjës, të cilët qe mesatarisht 15 vite kanë punuar tek Pavatex-i. Atyre fillimisht nga ndërmarrja u është ofruar vetëm masa sa për sy e faqe.

Copp-i rrit pagat minimale 2015

Unia me partnerët social ka arritur një rritje pagash prej 1%. Rritje të konsiderueshme kemi parasegjithash tek pagat minimale për punonjësit me shkollim profesional. Këto në vitin e ardhshëm rriten për 100 franga, pra në 4000 deri 4200 franga në muaj. Tek të punësuarit me shkollim profesional 2 vjeçar, rritja e pagës minimale është 2,6%. Për të pakualifikuarit paga minimale rritet rrishtas në 3850 franga herë 13 në vit.

Orar më i gjatë i hapjes së shitoreve?

Këshilli federal së fundi ka publikuar një propozim ligji për orarin minimal të shitjes. Qeveria donë që të futet orari minimal i shitjes që do të vrente nga ora 6 deri në ora 20 ditëve të punës dhe nga ora 6 deri në ora 19 të shtunave. Për shumë shitës/e kjo domethënë ditë më të gjata pune. Unia do të ndërmarr gjithçka ë është e mundur, për të penguar përkeqësimin drastik e të paarsyeshëm të kushteve të punës.

Reduktim të vendeve të punës tek Syngenta

Koncerni agronomik Syngenta i shlyen 1800 vende pune, nga to 500 në Zvicër (Bazel). Reduktimi nuk është i varur ekonomikisht, porse i shërben vetëm rritjes së përfitimit. Unia kërkon nga Syngenta një afat konsultativ të arsyeshëm dhe një plan social si dhe të tregon përgjegjshmëri. Unia e Zvicrës veriperëndimore fton qeverinë e Kantonit të ndërmarr gjithçka që është e mundur për të zvogëluar numrin e vendeve të reduktuara të punës dhe të sigurohet vazhdueshmëria e vend-punishtes.

Kontratat Kolektive të Punës, Bisedimet për paga

Bashkërisht për Kontrata më të mira Kolektive të Punës!



Pamje nga marrshi protestues i punëtorëve të ndërtimtarisë

Bisedimet mbi pagat në ndërtimtarinë janë duke çaluar, gjithashtu edhe bisedimet për ripërtëritjen e Kontratave Kolektive të Punës (KKP) për personelin e huazuar janë ndërprerë. Të dy shembujt tregojnë: Bisedimet për paga dhe për kontrata nuk janë gjithmonë të thjeshta dhe përmirësime mund të arrijmë vetëm nëse punëmarrësit bashkohen dhe luftojnë për tu arritur ato.

KKP për personelin e huazuar u kalon afati në fund të këtij viti, mirëpo bisedimet po çalojnë dhe ato tani për tani janë ndërprerë. Edhe në ndërtimtarinë bisedimet për paga janë duke shkuar keq. Këto janë shenja të këqija për bisedimet e ardhshme për ripërtëritjen e Kontratës Kombëtare të Punës. Mirëpo punëtorët e ndërtimtarisë në parlamentin e Unia-s i mbajtur në fund të nëntorit treguan se janë të gatshëm të luftojnë për një Kontratë të re Kombëtare të Punës.

Moti i keq në qendër të vëmendjes
Parlamenti i punëtorëve të ndërtimtarisë në fund të nëntorit aprovoi katalogun e kërkesave për bisedimet e vitit të ardhshëm që kanë të bëjnë me Kontratën Kombëtare të Punës për ndërtimtarinë kryesore. Si pikë të rëndësishme punëtorët e ndërtimtarisë e shohin mbrojtjen më të mirë të shëndetit të tyre në rast të motit të keq. Ata i nënshtrohen frymës dhe shiut, lëvizin nëpër skele të rrëshqit-

hme dhe janë jashtë sikur në acar ashtu edhe në rast vape të madhe.

Punëtorët e ndërtimtarisë janë të mllefosur

Parlamenti i punëtorëve të ndërtimtarisë ishte posaçërisht i mllefosur mbi ndërprerjen e pa respekt të bisedimeve për paga nga ana e shoqatës së ndërmarrësve (SVB). Pas mbledhjes punëtorët e ndërtimtarisë marshuan në shenjë proteste deri tek selia e shoqatës (SBV) dhe përmes një aksioni simbolik ndërtuan një mur në hyrje të selisë qendrore të shoqatës së ndërmarrësve ndërtues. Punëtorët e ndërtimtarisë përmes kësaj bënë me dije vendosmërinë se janë të gatshëm për të luftuar për një Kontratë të përmirësuar Kombëtare të Punës.

Bashkë të luftojmë, bashkë të fitojmë

Aksioni i punëtorëve të ndërtimtarisë tregon se vetëm të bashkuar mund të triumfojmë. Vetëm nëse punëmarrësit janë të organizuar në kuptimin sindikalist, atëherë edhe mund të negociojnë Kontrata Kolektive të Punës, të cilat sigurojnë kushte më të mira pune për të gjithë: dhe vetëm bashkërisht me punëtorët mund të arrihen përmirësime në KKP-të.

Aurora Garcia



Murosja e hyrjes në selinë e shoqatës së punëdhënësve

Moti i keq, Siguria në punë

Në rast rreziku ndalo!

Me dimrin vjen edhe acari e bora dhe bashkë me to edhe shumë rreziqe. Kështu të ftohtët e madh dhe toka e ngrirë nëpër kantieri paraqesin rritje të rreziqeve aksidentale. Në vijim do të trajtojmë masat mbrojtëse dhe cilat të drejta kanë punëtorët e ndërtimtarisë në raste të motit të keq.

Të ftohtët me ngrica vështirëson frymëmarrjen dhe shkakton ankesa të nyjave – ngarkesat trupore të punues gjatë ftohtët të madh për këtë arsye është e pashëndetshme. Dhe: Puna në rast fryme, shiu e bore rrit rreziqet aksidentale.

Masat e rëndësishme mbrojtëse në mot të ftohtë

Në rast të motit të ftohtë duhet të keni parasysh pika vijuese:

- Për punë në mot të ftohtë nevojitet më shumë kohë: planifikim më i mirë;
 - Më shumë pauza për tu ngrohur në hapësira të nxehta dhe me pija të nxehta;
 - Rroba mbrojtëse (dorëza, rroba të epërme shtesë të ngrohta dhe të terura);
 - Në rast të ftohtët të madh, akullit dhe borës duhet të ndërpritet puna. Punëdhënësi në rast nevojë mund të paraqet kërkesë kompensimi për shkak të motit të keq.
- Është me rëndësi: nëse ka rreziqe për shkak të motit të ftohtë, borës apo shiut ekziston e drejta të ndër-



Punëtorët e ndërtimtarisë u nënshtrohen rreziqeve të shumta

pritet puna. Ndërtuesit (ndërmarrës) nuk ndërpresin punën vetvetiu edhe në kushte të mjerueshme moti. Megjithatë punëmarrësi ka të drejtë të dëgjohet në situata të tilla nga ana e punëdhënësit.

Kontrata e Kombëtare mbron

Kontrata Kombëtare e Punës (LMV) mbron shëndetin e punëtorëve të ndërtimtarisë. Neni 28 përcakton që punët jashtë në rast shiu, bore e moti shumë të ftohtë nëse e lyp nevoja duhet mundësisht edhe të ndërpritet. Pasi në bazë të ligjit punëdhënësi është përgjegjës për shëndetin e punëmarrësve, ai edhe duhet që në rast të motit të dëmshëm për shëndetin, të ndërpres punën. Nëse ai nuk e bënë këtë vetvetiu, atëherë punëtorët e ndërtimtarisë duhet të kërkojnë bi-

sedën me përgjegjësin e kantierit. Nëse ka probleme në realizim të kësaj të drejte, atëherë gjithsesi të duhet njoftuar seksioni i Unia-s në regjionin përkatës.

Kompensim në rast aksidenti në punë

Të gjithë punëtorët e ndërtimtarisë (përfshi edhe punonjësit temporal) kanë të drejtë të vijnë të marrin pagën edhe për orët që nuk është për shkak të motit të keq. Kjo e drejtë është e ankoruar në Kontratën Kombëtare të Punës. Sipas llojeve të orëve të munguara ekzistojnë edhe rregulla të ndryshme për kompensimit të orarit të punës dhe ku parashihet lartësia e pagesës vijuese. Ndërprerjet e shkurta për disa orë, shembulli bie për shkak të shiut të fuqishëm, mund të:

- Nxihen direkt në muajin e njëjtë,
 - Të kompensohen përmes ndryshimit të kalendarit kohor të punës në një kohë të mëvonshme, apo
 - Të përlogariten si orë mbi orarin e paraparë të punës
- Ndërprerjet e punës për disa ditë punëdhënësi mund të.
- Ti balancoi në kalendarin kohor të punës. Mirëpo: Të gjitha orët mbi orarin javor prej 48 orësh duhet të paguhen menjëherë me gjithë shtesën prej 25%. Këto orë pra nuk mund të përdoret për orë të humbura.
 - Të përlogariten si orë mbi orarin e paraparë të punës
- Në rast të ndërprerjeve më të gjata për shkak të ftohtët që zgjat apo të borës së pareshtur – punëdhënësi mundet dhe duhet që kohën e humbur ta lajmëroi tek sigurimi në rast moti të keq. Sigurimi për raste të motit të keq funksionin njëjtë sikur sigurimi aksidental: Nga dita e 3-të e humbur do të kompensohen 80% e pagës së fundit të paguar. Paraprakisht duhet që orari i bilancit kohor të reduktohet në 20 orë mbi orarin e paraparë të punës. Dy ditët e pritjes, të cilat sipas rregullit nuk paguhen nga sigurimi, duhet ti marr përsipër punëdhënësi.

Aurora Garcia



Mehr Schutz bei Schlechtwetter. Wir verdienen es!

Të drejtat sindikaliste

Vendimi udhërrëfyes i gjyqit federal



Pamje nga aksionet mbi të drejtat e sindikalistëve

Derisa zhvillohej një betejë për të drejtat në punë, Radio Freiburg i largon nga puna dy përfaqësues të personelit. Padrejtësisht, thekson gjyqi federal.

Në fillim të vitit 2010 në Radion private Freiburg ziente. Pas largimit të bashkë-drejtorit gjermano-folës, bordi i drejtorëve donte të këtë vend puna ta eliminonte tërësisht. Partneri i tij bashkë-drejtorit franko-folës do të duhej rishtas të drejtonte si shef i vetëm. Kjo i bëri të punësuarit të mendohen. Ata e panë të rrezikuar principin e dygjuhësisë. Vetë bordi i drejtorëve dhe idenë që të punësuarit të mund të bashkë vendosin për ristrukturimin. Personeli zgjodhi një delegacion prej katër vetash, ndër të cilët edhe gazetarin André Hügli.

Arsye të qëndrueshme

Mirëpo bordi i drejtorëve nuk e kishte për qëllim bashkërendim e vërtetë. Hügli kujton: «Propozimet tona nuk i merrnin seriozisht. Ata vetëm donin të na përdorin për realizimin e qëllimeve të tyre». 32 punonjës Radioje kundërshtuan me një komunikatë të përbashkët për media. Kjo ju duk si e tepërt bordin e drejtorëve. Ata hodhën në rrugë gazetarin Hügli dhe kolegun e tij Jean Godel. Me ndihmën e sindikatës Syndicom Hügli dhe Godel bënë padi për largim keqpërdorues nga puna tek Dhoma e Tregtisë. Dhe atyre iu dha e drejta. Radio Freiburg e vazhdoi rastin në të gjitha instancat tjera gjyqësore: Katër vjet më vona, tani edhe gjyqi federal si instanca e fundit vendosi: largimi i gazetarëve nga puna ishte i kundërligjshëm. Ligji ndalon që të largohen nga puna

të përzgjedhurit e personelit – nëse për këtë largim nuk ka arsye të qëndrueshme. Këto arsye Radio Freiburg sipas gjyqit federal nuk ka mundur ti paraqes e ti dëshmoj.

Vendim i rëndësishëm

Eksperti i së drejtës në punë nga Unioni i Sindikatave Zvicerane, Luca Cirigliano me kënaqësi nxjerr përfundimin: «Gjyqi federal këtë radhë ka marrë seriozisht mbrojtjen e përfaqësuesve të personeli». Me rastin e largimit nga puna të një përfaqësuesi të personelit punues tek Koncerni Tamedia, ky gjyq ka pas vendosur ndryshe. «Me vendimin e ri është e qartë: Nëse Firma flak nga puna përfaqësuesin e personelit, obligimi i paraqitjes së dëshmive i bie asaj». Ky është një vendim i rëndësishëm për sindikalistet e sindikalistët.

Marco Geissbühler, përshtatur nga work Nr. 18, 7 nëntor 2014

Stresi në vendin e punës

Kontrolli i orëve të punës eviton stresin në punë

Tema e stresit ishte në qendër të vëmendjes së mbledhjes të përgjithshme vjetore të delegatëve të sektorit të profesioneve shërbyese të mbajtur në tetor. Me një rezolutë delegatët kërkojnë posaçërisht evidentimin korrekt të kohës së punës, për ti mënjeluar keqpërdorimet dhe për të parandaluar sëmundjet psikosociale.

Evidentimi korrekt i kohës së punës është një preokupim i rëndësishëm i të punësuarve në sektorin e shërbimeve, në të cilin kjo çështje është pamjaftueshëm e rregulluar. Ndërmarrjet sa vjen e i ulin harxhimet e personelit, duke mos lejuar pauzat, duke mos llogaritur orët efektive të punës dhe duke bërë edhe më fleksibël kushtet e punës përmes punës sipas nevojës.

Stresi i përhapur

Një studim i publikuar para një kohe të shkurtër tregon se, 33% e të punësuarve vuajnë nga stresi në punë. Njëkohësisht tek 1/6 e të punësuarve nuk evidentohet koha e punës, gjë që i hap dyert krah me krah keqpërdorimit të mundshëm. Kështu Unia vëren rregullisht shkelje kundër ligjit

të punës, gjë që qon në rritje shqetësues të sëmundjeve psikosociale të ndërlidhura me punën. Në një sektor me përqindje të lartë të grave pos kësaj duhet të merret në konsideratë edhe pajtueshmëria e punës me obligimet familjare.

Përmirësimi i kontrollit të kohës së punës

Delegacioni i Unia-s kërkon për të gjitha profesionet e sektorëve të shërbimeve përllogaritje të detajuara dhe përmirësim të kontrollit të orarit të punës, ditë të lira fikse nga puna për të punësuar me orar të reduktuar si dhe përllogaritje të kohës së trajnimit dhe shërbimit kujdestar. Këto preokupime duhet të zbatohen përmes zgjerimit dhe forcimit të Kontratave Kolektive të Punës.



Aparatit matës i orarit të punës

Në 2015 realizohen kampanja me ketë temë. Kampanja e parë fillimisht do të zhvillohet sipas motos «çdo minutë numërohet» për shitjen me pakicë. Ndër të tjera të punësuarit do të marrin një librezë për shënimin e orëve, e cila atyre do tu mundëson të kontrollojnë evidentimin korrekt të kohës së punës.

Aurora García

Intervistë



Sektori i migracionit: Marilia Mendes, Osman Osmani, Aurora Garcia

Kongresi i parë i migranteve e migrantëve

Për një perceptim të ri të migrantëve!

Bashkë me Organizata tjera sektori për migracion në Unia do të organizojë kongresin e parë të migranteve e migrantëve. Ky do të mbahet më 7 shkurt 2015 në Hotel Bern të Bernës, pikërisht me rastin e njëvjetorit të aprovimit të iniciativës mbi migrimin masiv të 9 shkurtit 2014. Horizonte ka zhvilluar bisedë me bashkëpunëtorët e sektorit për migracion për arsyet e këtij kongresi.

Përse një kongres të migrantëve?

Marilia: Rrethet të djathta popullsitë e shfrytëzojnë gjithnjë e më shumë «migracionin» si temë, për të fuqizuar pikëpamjet dhe pozicionin e tyre në politikë. Në kohë krizash njerëzit janë të pasigurte dhe kërkojnë fajtorë: këtë e shfrytëzojnë forcat e djathta popullsitë, për të krijuar një klimë kundër grupet e dobëta në shoqëri: migrantët, refugjatët, marrësit e ndihmës sociale... Me këtë rast përhapin frikë kundër migrantëve duke i fshehur pabarazitë e shumta. Me këtë kongres ne duam të kundërshtojmë epitetin e parazitit, që popullistët e djathtë kanë përhapur për migranteve e migrantëve dhe njëherazi duam të mbrohem dhe të tregojmë se sa të rëndësishëm jemi ne për shoqërinë zvicerane. Ne duam të forcojmë vetëdijen tonë dhe të hapim rrugën për të bashkëbiseduar mbi çështjet shoqërore. Ne jemi pjesë e shoqërisë – dhe ne duam të veprojmë e të perceptomi si të tillë!

Çfarë shpresojmë ne nga kongresi?

Aurora: Posaçërisht që popullata e migrantëve të mobilizohet kundër diskursit ksenofob. Ne nuk duam të rrimë duarkryq dhe pa vepruar, porse aktivisht të ndryshojmë perceptimin e migrantëve! Është koha që ne të marrim fjalën dhe të mos lejojmë që të tjerët të flasin në emër tonë.

Cila është përmbajtja e kongresit të migrantëve?

Osmani: «Të drejta të njëjta për të gjithë migrantët» dhe «Siguri për lejet e qëndrimit» do të jenë preokupimet tona kryesore. Pastaj ne do të trajtojmë një manifest, i cili duhet të na shërbejë si bazament për qëndrime të përbashkëta dhe për aktivitetet vijuese që dalin nga ai, e i cili do të diskutohet e të aprovohet. Edhe aktivitetet ne fjalë do ti diskutojmë dhe do të aprovojme një plan aksioni. Kjo duhet të kontribuoj që diskutimet mos të mbesin thjeshtë vetëm fjalë., mirëpo me të vërtetë të zbatohen në vepër. Kjo domethënë që kongresi i migrantëve të përcaktojë masa konkrete. Posaçërisht llogarisim me migrantët aktivë – do të ftohen shoqatat aktive të migrantëve për të marrë pjesë në kongres.

Kush duhet të marrë pjesë në këtë kongres?

Aurora: Para së gjithash përfaqësues të Organizatave të migrantëve: ne jemi duke përgatitur ftesat për organizata të shumta të tilla ku kërkojmë që të dërgojnë 2-5 përfaqësues në kongres. Do të ishte me rëndësi që sa më shumë migrantë të marrin pjesë, posaçërisht ata që janë nga grupet më të mëdha të migrantëve në Zvicër.

Si do të mundësohet komunikimi mes gjithë këtyre migrantëve?

Marilia: Është me rëndësi të pjesëmarrësit të njohin njëri-njëri nga gjuhët e vendit: gjermanishten, frëngjishten apo italishten, pasi do të ofrohet edhe përkthimi në njëri-njëri nga këto gjuhë. Këtë duhet ta kenë parasysh organizatat pjesëmarrëse me rastin e lajmërimit të përfaqësuesve (e delegatëve) të tyre.

Angazhohuni bashkë me ne dhe bindni edhe të tjerët të na bashkëngjiten!

10 vjet Unia


Një sindikatë në lëvizje

Duket si e pabesueshme: Unia sivjet arrin moshën 10 vjeçare. Dhe ajo përbën një histori suksesi. Unia sot është sindikata më e madhe dhe më e fuqishme e Zvicrës. Për shumikënd emri «Unia» është mishërim i përgjithshëm sindikalist. Realiteti zviceran nuk mund të mendohet pa te, dhe duket sikur Unia ka ekzistuar gjithmonë.

Në vitet e 90-ta sindikata e ndërtimtarisë dhe industrisë (GBI) si dhe sindikata e industrisë, tregtisë, shërbimeve (SMUV) punonin bashkë në projekte të shumta. Pas diskutimeve të brendshme jo edhe aq të thjeshta erdhi deri tek arritja: në vitin 2004 në Bazel u zhvillua kongresi themelues i Unia-s. Sindikatat më të mëdha GBI dhe SMUV arritën të fuzionojnë me sindikatën e vogël të sindikatave të shërbimeve VHTL (Sindikata e shitjes, tregtisë, transportit dhe artikuljeve ushqimor), unia si dhe ACG (Shoqata e nëpunësve të Gjenevës). Një fuzion i tillë do të mundësojë që sektori i shërbimeve më në fund të organizohet sindikalist. Bashkimi i fuqisë do të duhej të rriste mundësinë goditëse të sindikatave psi Aftësia mobilizuese si dhe aftësia luftarake do të duhej të bëhej më e madhe përmes Unia-s.

Suksese nëpër sektorë

Përkundër shumë vështirësive ne mund të flasim për zhvillime të suksesshme në sektorë të shumtë ekonomik. Ndërtimi i mëtejshëm i sektorit terciar vijon më tutje. Tanimë Unia numëron 50000 anëtarë nga sektori i shërbimeve, dyfish më shumë se sa në vitin 2004. Bashkimi i forcave ka shënuar përparime gjithashtu edhe në sektorët tradicional. Kështu në sektorin e tregtisë të rritet prezenca sindikalist dhe që i tërë sektori të mbulohet me Kontrata Kolektive të Punës. Në sektorin e ndërtimtarisë kryesore, konfrontimeve e shumta mbi Kontratën Kombëtare të Punës në vitin 2007 dhe 2011 kanë treguar



se, Unia është në gjendje të udhëheq bisedime të gjithmbarshme. Këtu duhet pasur parasysh se një gjë e tillë është vështirësuar mjaft për shkak të uljes së stafit të përhershëm të punonjësve nëpër ndërmarrje dhe rritja e sub-ndërmarrjeve (nënkontraktuesve) si dhe rritja e numrit të të punësuarve temporal. Një fitore vendimtare strategjike ka arritur të festoi sektori i industrisë ku janë përcaktuar për herë të parë pagat minimale në KKP të MEM (Industria e metalit, elektrike dhe ajo e makinave).

Angazhim i vazhdueshëm edhe për migrantët

Në 10 vitet e fundit Unia është angazhuar fuqishëm në shumë lëmi: qoftë në pensionimin e mëhershëm për sektorin e ndërtimtarisë dhe tregtisë, qoftë kundër orarit të zgjatur të punës në shitore, apo edhe kundër dumpingut në paga dhe vjedhjes së pensioneve. Edhe për migrantët është angazhuar Unia vazhdimisht. Qoftë për të drejtat nga rrafshi i sigurimeve shoqërore apo edhe kundër iniciativave të panumërta ksenofobe sikur ajo për dëbim ose atë mbi migrimin masiv. Në të ardhmen ky angazhim do të fuqizohet edhe më shumë!

Aurora Garcia

Të drejtat e punëtorëve në Kosovë

Ka punëtorë që nuk janë paguar për shtatë muaj rresht

Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat të Kosovës ka publikuar të gjetura të shumta sa i përket raportit punëdhënës – punëmarrës. Sipas këtyre të dhënave, SPEVZ tregon se ka shumë parregullsi në raportin punëdhënës – punëmarrës. Ka punëtorë që paguhet me vetëm 120 euro në muaj, si dhe të tillë që nuk kanë marrë rrogë që shtatë muaj.



Fuqia e lirë e punës që trajtohet pa respekt nga punëdhënësit

Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi, ka raportuar para organeve të saj për punën që është bërë nga 1 shtatori i këtij viti e deri më sot. Parregullsi, sipas SPEVZ-it përpos në «Omi Impex» në Qendrën Studentore janë gjetur edhe në FSK në Kazermin «Adem Jashari», ku shërbimet teknike i kryen kompania «MSS».

Kjo kompani, SPEVZ thotë se pesëmbëdhjetë punëtorët e saj i paguan me vetëm 120 euro pagë neto, e cila pagë është në kundërshtim të plotë me ligjin e punës dhe Marrëveshjen Kolektive.

«Ka punëtorë të kësaj kompanie që udhëtojnë edhe nga 30 km për të ardhur në punë, këta punëtorë nuk gëzojnë të drejtën e ushqimit, transportit e as të pushimit vjetor konform ligjit», thuhet në njoftimin e tyre.

Punëtorë që nuk lejohen të formojnë sindikatat e tyre

SPEVZ, thotë se në Kosovë, ka kompani që i frikësojnë punëtorët të bëjnë organizimin sindikal, pasi që nuk donë që ky mekanizëm ti zbuloj parregullsitë që bëhen në këto kompani. «Kompania 'Dervisholl', dhe 'Interaksi' nuk lejojnë themelimin e shoqatave edhe përkundër asaj se ne zyrtarisht kemi kërkuar nga pronarët që të ndihmojnë themelimin e sindikatave, pasi që e kanë obligim ligjor, të këto kompani janë vërejt parregullsi të skajshme në implementimin e ligjit», thuhet më tutje në njoftim. E për të pasur një zbatim të marrëveshjes kolektive, SPEVZ beson se do të arrij që përmes protestave të ndryshojë këtë gjendje, dhe nga 1 janari 2015, të fillojë zbatimin e plotë të marrëveshjes kolektive.

Osman Osmani, marrë e përshtatë nga Koha Ditore e datës 23 Tetor 2014

Ju pyesni, Unia përgjigjet



Dëme në automjet: A duhet të paguajmë ne?

Për të drekuar unë bashkë me një koleg pune morëm automjetin e Firmës për të shkuar deri në restorant. Pas ngrënies e pamë që pjesa mbrojtëse përmbropa ishte e shtypur, mbyllësi i gepekut ishte i dëmtuar dhe si dritat ishin të prishura. Nuk e kishte vërejtur askush, se kush ka shkaktuar dëmet. A duhet ne në këtë rast të paguajmë diçka, pasi ne karshi sigurimit nuk dinim se kush ishte shkaktari i dëmit?

Jo. Dhe atë për dy arsye. Nga këndvështrimi i të drejtës së punës, punëmarrësit janë përgjegjës vetëm për dëmet, të cilat i kanë shatuar me qëllim apo nga pakujdesi. Kjo me këtë rast nuk qëndron. Sipas të drejtës së sigurimit vlen fakti se Firma duhet të lidh një sigurim për automjetet e saja. Pos kësaj ekziston edhe Fondi Garantues Zviceran (NGF). Ky mbulon përgjegjësitë për dëmet e shkaktuara nga të pidentifikuarit dhe për automjetet, rimore dhe biçikletat e pasiguruara e të dëmtuara në Zvicër apo Liechtenstein, në rastet kur ekziston obligimi për ti siguruar ato. Ky formulim i komplikuar domethënë që Fondi Nacional i Garantimit i Zvicrës merr përsipër dëmet, kur shkaktari i aksidentit është i panjohur, apo kur ligji për një automjet parasheh sigurimin e detyrueshëm, e i cili është anashkaluar dhe pastaj ndodh aksidenti. Në rend të parë e gjithë procedura zhvillohet përmes sigurimit të punëdhënësit. Pastaj sigurimi i tij mund të kërkojë kompensimin nga Fondi Garantues.

Philip Thomas, work, 6.11.2014

Aksident: Nga kur kam të drejtë në pagë?

Gjatë punës më ka ra një kuti e rëndë në këmbë. Mjeku im për këtë arsye më lëshoj një vërtetim me shkrim për një javë 100% i paaftë për punë. Fatmirësisht ishte vetëm një lëndim i vogël, dhe pastaj unë pa pasoja e kufizime tjera munda të vazhdoja punën time. Pasi kontrollova rrogën time pash se unë nuk isha paguar për dy ditët e para të paafësisë sime për punë. A nuk është ashtu, se unë, që nga dita e parë kam të drejtë në 80% të pagës sime?

Po, ju keni të drejtë. Mirëpo, tani vlen ajo që sigurimi aksidental duhet të paguan parat ditore tek nga dita e tretë pas aksidentit (shih. Nenin 16. Pikën 2 të UVG). Kështu juve ju krijohet një periudhë pritjeje prej dy ditësh. Këto sipas të drejtës obliguese duhet ti mbuloi punëdhënësi juaj (krahaso Nenin 324 b, Pikën 3 të OR). Firma juaj pra duhet ti merr vet përsipër këto dy ditë. Nga dita e tretë e pastaj paguan sigurimi aksidental. Me rastin e një paafësie të plotë pune, sikur në rastin tuaj, merrni parat ditore në lartësinë 80% të të ardhurave tuaja të siguruara (tani për tani maksimalisht 276 franga në ditë). Edhe Firma juaj duhet të ju paguaj ju për dy ditët e para 80% të pagës. Sipas rregullit sigurimi aksidental parat ia paguan punëdhënësit. Këtë shumë pastaj ai ua dërgon juve më tej.

Thomas Baumgartner, work, 23.10.2014

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. Garcia, D. Filipovic, E. Sariassian, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.